

S T A T U T I
I
SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
„Pizza Chanel“ SH.P.K

EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI

Neni 1
Themelimi

Sot më 5 Maj 2023

Themelohet Shoqëria tregtare **“Pizza Chanel”** sh.p.k si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në zbatim të ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” nga ortaku i meposhtem:

- I- Salvatore Menza** shtetas Italian, lindur në Lodi (LO), Itali, e datëlindjes 28.07.1992 banues në rruga Viale Cesare Vignati, N.5 Lodi (LO), Itali, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e dokumentit identifikues Karte Identiteti nr.CA59093KN.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr.9901 dt.14.04.2008 “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

Kjo shoqëri fiton zotesinë për të vepruar pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë, qëndër e cila pas miratimit të regjistrimit të shoqërisë e pajis atë edhe me NUIS-in përkatës identifikues.

Neni 2
FORMA DHE EMERTIMI

2.1 Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për sa kohë asambleja e ortakeve nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj.

2.2.Emërtimi i shoqërisë është **“Pizza Chanel”** sh.p.k.

Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët **“Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar”** ose inicialet Sh.p.k.

NENI 3
BAZA JURIDIKE

4. Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 4
SELIA

5.Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë.

Ne adresen: Rr.Reli, Pall. Nr,1, kati pare Hyrja 3, Selite, Farke, Tirane, dhe mund te ndryshojë seline e saj me vendim të ortakeve.

NENI 5
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

- Konsulence dhe sherbime ne fushen financiare dhe mbrojtje ne gjykate ose ndermjetesime, marketingut, menaxhimit,.
- Ndermjetesim dhe kosulenc ne dhënien me qira të pasurive të paluajtshme në pronësi të kompanisë dhe nën qira të ndërtesave të palëve të treat.
- Regjistrimi I markave dhe dhenia me franchising
- krijimi, zbatimi dhe organizimi i takimeve, ekspozita, konferenca, ngjarje, mbremje dhe evente në përgjithësi, synon gjithashtu në promovimin, shpërndarjen dhe zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të mësipërme, si dhe krijimin e grupeve të trajnimit, me qëllim për të kryer aktivitete informative dhe formacioni në një kuptim të gjerë;

- Kompania gjithashtu mund të kryejnë të gjitha transaksionet tregtare dhe financiare dhe të zbatojë të gjitha nismat që lidhen me arritjen e objektivave sociale, duke përfshirë të gjitha aktivitetet që lidhen me pronën e luajtshme dhe të paluajtshme

Per kryerjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme, per te cilin do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organi kompetent.

NENI 6
KOHËZGJATJA

7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar, duke filluar nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 7

TERRITORI

5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

KAPITULLI III AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQËRISË, KONFIDENCIALITETI

NENI 8 FUSHA E AUTORITETIT TË ORTAKUT

8.1 Fusha e autoritetit të ortakut dhe përqindja e fitimeve ose e humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e Shoqërisë si dhe kompetencat që gëzon ortakut në marrjen e vendimeve të çdo karakteri, të përcaktuara në këtë statut.

NENI 9 LIBRI I SHOQËRISË

9.1 Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, Shoqëria do të çelë librin e vet i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.

NENI 10 KONFIDENCIALITETI

10.1 Ortaket e shoqërisë si dhe personat e tjerë të pranuar në Shoqëri bien dakord që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që disponon Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë, çdo lloj material, si dhe planet ose qëllimet që ajo ka për të ardhmen e saj.

NENI 11 DOKUMENTET E DESTINUARA PËR TË TRETËT

11.1 Të gjitha aktet dhe dokumentat që nxiren nga Shoqëria dhe janë të destinuar për të tretët, si letrat, faturat, lajmërimet, publikimet e ndryshme etj., duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas tij fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet “SH.P.K”, si dhe emrin e administratorit.

NENI 12 KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, Pjesët dhe Transferimi i Tyre

12.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë në **Leke**, 1.200.000,00 (njemilione e dyqind *mije* lekë).

12.2 Kapitali themeltar është i ndarë në 1(një) kuota.

12.3 Ky kapital themeltar i shoqërisë është i zotëruar nga Ortaket si me poshte

- 2- **Salvatore Menza** shtetas Italian, lindur në Lodi (LO), Itali, e datëlindjes 28.07.1992 banues në rruga Viale Cesare Vignati, N.5 Lodi (LO), Itali, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e dokumentit identifikues Karte Identiteti nr.CA59093KN, **zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë nominale 1.200.000,00 (njemilione e dyqind mijë) lekë e barabrte me 100% te kapitalit te shoqërisë. Ortaku ka të drejtë të tjetërsojë, të zmadhojë apo të paksojë kuotat e kapitalit deri në kufinj të percaktuara nga ligji**

Kalimi dhe fitimi i kuotave të shoqërisë do të behët në përputhje me nenet 72- 75 të ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”.

12.5 Kapitali fillestar i shoqërisë nuk është paguar.

Neni 13

Transferimi i kuotave dhe zmadhimi i kapitalit

- Pjeset e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, apo ndarje pasurore mes bashkëshortëve.
- Transferimi i pjeseve të kapitalit themeltar si trashgimni ose brenda familjes personave perfitues do ti behet pasi ata te pranojne permbajtjen e statutit te kesaj shoqërie tregtare me gjithë ndryshimet qe ai mund te kete pesuarderi ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar te behen lehtesisht te transferueshme.
- Ne raste mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund t transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqëri vetem me miratimin e ortakeve

Transferimi i kuotave te kapitalit themeltar te secilit ortak themelues, ne persona te tjere jo ortake te shoqërisë do te behet vetem me miratimin e Asamblese se Ortakeve. Ne çdo rast ortaku qe kerkon te largohet nga shoqëria, duhet te respektoje te drejten e parablerjes se kuotave nga ortaket themelues te shoqërisë. Ne rast se kuotat e ortakut themelues jane te tilla qe kane nje çmim tregu te ndryshueshem do te merret si çmim i pranuar çmimi me i larte i shitjes, çmim i konfirmuar me garanci oferte te verifikueshem nga pjesmarresit e Asamblese se shoqërisë. Në rast vdekjeje të ndonje prej ortakëve te shoqërisë trashëgimtarët e tij apo rast ndarje pasurore midis bashkeshortëve, subjektet perfitues sipas ligjit kane të drejtë të vendosin për likuidimin e shumës së kapitalit te shoqërisë ose për vazhdimin e veprimtarisë sipas parashikimeve ne ligj nepermjet trashëgimise dhe pjesmarrjes se trashëgimtareve ligjore ne shoqëri apo bashkepjesmarrjes nga ndarja e pasurise bashkeshortore. Ortaket e kesaj shoqërie, mund të vendosë të shtojë kapitalin themeltar të shoqërisë në çdo periudhë që e shoh të nevojshme. Zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë do të bëhet

sipas parashikimeve të këtij Statuti dhe nenit 81 të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare".

ORGANI DREJTUES
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 14
Asambleja e Ortakeve

Secili aksionar ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e mbledhjes së aksionarëve dhe mund të ketë një numër votash të barabarta me aksionet e kapitalit të zotëruar.

Një anëtar mund të përfaqësohet në një mbledhje të përgjithshme në bazë të një delegimi nga një partner tjetër, bashkëshorti ose personi tjetër i caktuar prej tij, me kusht që të autorizohet nga një prokurë.

Asambleja e ortakeve perbehet nga mbledhja e 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë. Ajo mbledhet me kërkesën e Administratorit. Gjithashtu secili prej ortakeve ka të drejtë t'i paraqesë Administratorit kërkesë me shkrim për mbledhjen e asamblese të përgjithshme duke treguar në të arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Në rast se kërkesa refuzohet, ortaku kanë të drejtë të thërrasë asamblenë dhe të caktojë çështjet e rendit të ditës.

Permbajtja dhe rendi i ditës iu njoftohet ortakeve të pakten 7 dite përpara mbledhjes së Asamblese, në rastin e shoqërisë njoftimi iu behet të ditur të gjithë ortakeve themelues. Mbledhja quhet e vlefshme kur me një nga menyrat e percaktuara në ligj, është bërë njoftimi i ortakeve të shoqërisë (pjesëmarrësve të themeluesve), me konfirmim shkresor duke percaktuar edhe rendin e ditës së mbledhjes. Në rast se pjesëmarrësit marrin pjesë personalisht ata do të konsiderohen të njoftuar pavarësisht nëse nuk ka konfirmim me shkrim. Pjesëmarrësi në mbledhje mund të jete vete ose të përfaqësohet nga një tjetër person të caktuar me Prokurë përfaqësimi, duke patur të shprehur objektin e mbledhjes në mbledhjen e Asamblese.

Vendimet e asamblese të cilat merren me shumicë të thjeshtë do të jenë të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Vendimet të cilat merren me shumicë të kualifikuar do të jenë të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave. Do të merren me shumicë të kualifikuar prej $\frac{3}{4}$ të kuotave pjesëmarrëse vendimet për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Të gjitha vendimet e tjera do të merren me shumicë të thjeshtë. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregëtare të Shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabël të autorizuar;

- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d, të kzsaj pike;
- f) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët , përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë të veprimtarisë ;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre ;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proçedimet e tjera ndaj administratorëve
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l) Krijimin e fondeve, përbërjen, madhësinë, burimet e krijimit, mënyra dhe kushtet e pzdorimit.
- m) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 15

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme mblidhet në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit ndërsa mbledhjet e jashtëzakonshme bëhen sa herë çmohet e nevojshme nga ortaket. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori apo ortaket sipas nenit 84 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”.

NENI 16

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e Ortakeve ka per kopetence :

Vendos për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe përpilon ose miraton rregulloret për Shoqërinë apo për sektorë të veçante të veprimtarisë.

-Te emeroje apo shkarkoje Administratorin e shoqërisë, pronar ose jo pronar.

-Të jape ose jo pelqimin per caktimin e ekspertit kontabel nga Administratoret e shoqërisë, i cili do te beje auditimin e vitit ushtrimor;

-Të informohet në çdo kohë për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentacionin e saj ;

-Të vendosë për kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me ekspertë të caktuar prej saj ose te kerkuar nga çdo ortak ;

- Te jape ose jo miratimin per marrjen e çdo lloj huaje apo kredie bankare.

-Te jape ose jo miratimin per shtimin e kapitalit apo pakesimin e tij.

-Te vendose per miratimin ose jo te largimit te ortakut ne rast te shitjes se kuotave dhe zevendesimin e tij me nje person tjetër.

-Komptenca te tjera që parashikohen ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË
NENI 17
ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

Kompania mund të administrohet nga administratori i vetëm ose administratorët e shumtë, të cilët mund të jenë persona fizikë të emëruar brenda komunitetit ose jashtë këtij komuniteti. Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rimerimi. Emërimi i administratorit jep efekte ligjore vetëm pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratori i një shoqërie tregëtare mëmë, nuk mund të emërohen si administrator i kësaj shoqërie.

Administratori të detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregëtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm që ushtron detyrat e Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Në rastet e parashikuara nga statuti dhe në rastet e tjera te parashikuara në ligj, administratori është i detyruar të paraqese raport te ortakut i vetëm apo të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme në rast se do të ketë shtim të ortakëve të shoqërisë.

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë te zakonshme.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Administrator i shoqërisë është :

1-Z. **Afrim Ismaili** shtetas Shqiptare, lindur në Skrapar, Shqiperi, e datëlindjes 20.03.1975 banues në Sauk Rr. Danish Jukniu 19 , Tirame, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e dokumentit identifikues karte identiteti (Identity card) nr. Personal H50320285B, me afat emërimi për 5 vjet me të drejtë riemërimi.

LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI , DIVIDENTET

NENI 18

LIBRAT E SHOQËRISË

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç Librit të Shoqërisë, në të cilin shënohet emri i plotë i ortakut, kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakut të vetëm edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

NENI 19

BILANCI

Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga ortakut i vetëm.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

NENI 20

DIVIDENTET

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe duke theksuar ekzistencën e fitimeve, mbledhja e aksionarëve përcakton pjesën e anëtarëve në formën e dividentëve mbi fitimet, në përpjesëtim me përqindjen e pjesëmarrjes së secilit aksioner në kompani. Fitimet që do të shpërndahen midis anëtarëve në përpjesëtim me aksionet e kapitalit të kompanisë, përbëhen nga fitimi i vitit në të cilin janë zbritur shumat e rezervuara për fondin e domosdoshëm të aksioneve (5% të fitimeve) të secilit vit, derisa ky fond arrin vlerën 1/10 të kapitalit të kompanisë dhe, nga ana tjetër, humbjet ose të ardhurat e mbajtura nga vitet e mëparshme zbriten ose rriten respektivisht.

MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

NENI 21

MBARIMI



22.1 Shoqëria mbaron me vendim të ortakut të vetëm ose kur ka një prishje të parakohshme për arsyet e parashikuara në ligj.

NENI 22
LIKUJDIMI

23.1 Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortaku cakton një ose disa likujdues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Në fund të procesit të likujdimit, ortakët vendosin mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likujdimit. Mbas pagimit të kreditorëve ortaku i vetëm mban pjesën e mbetur të kapitalit.

MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA E FUNDIT
NENI 23
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare, pasi të jete ezauruar mundësia e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me mirkuptim midis ortakëve.

NENI 24
DISPOZITA E FUNDIT

Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.

Shoqëria do të ketë vulën e saj, forma dhe madhësia e së cilës do të përcaktohen nga Ortaket e shoqërisë.

Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

Tiranë , me 05.05.2023

ORTAKU I VETEM
Salvatore Menza